



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Në bazë të nenit 17 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 17.1 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, nr. 04/L-174 dhe nenit 19 shkronja b të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2015, miratoi,

VENDIM

PËR INICIMIN E PROCEDURËS PËR HARTIMIN E PROPOZIMIT TË KORRIGJIMEVE TË PLANIT RREGULLUES URBAN “ ZONA QENDËR “ NË PODUJEVË

Neni 1

Inicohet procedura për hartimin e propozimit të korrigjimeve të Planit Rregullues Urban “Zona Qendër” në Podujevë, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës, nr. 01/110-350 të datës 28 maj 2012.

Neni 2

Korrigjimi i Planit Rregullues Urban të bëhet në pajtim me Vendimin e Inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Nr. 1876/12 të datës 18.07.2012, përkatësisht të kompletohet dhe plotësohet me të gjitha elementet e parapara konform dispozitave ligjore dhe dispozitave nënligjore.

Neni 3

Gjithashtu të harmonizohet pjesa tekstuale me pjesën grafike të Planit.

Neni 4

Hartimin e propozimit të korrigjimeve të Planit përkatës e bënë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Neni 5

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-350-36515
Podujevë,
31 mars 2015



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi